



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, me 11.02.2019

Dokument parlamentar

R A P O R T

PËR ZGJEDHJEN E TRE KOMISIONERËVE TË AVOKATIT TË POPULLIT

Hyrje:

Në zbatim të nenit 33/1 pika 7, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, si dhe nenit 111, të Rregullores së Kuvendit, “Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”, në mbledhjen e datës 17.12.2018, zhvilloi seanca dëgjimore me kandidatët për komisionerë të Avokatit të Popullit, për (3) tre seksione vakante. Gjatë seancave dëgjimore kandidatët prezantuan platformat e tyre në lidhje me pozicionet që konkurrojnë, si dhe iu përgjigjen pyetjeve të deputetëve për formimin e tyre akademik, profesional, dhe motivimin që kanë për të kandiduar në seksionet përkatëse.

I - Kandidaturat e paraqitura nga Avokati i Popullit për Komisioner të tre seksioneve:

1 – Për pozicionin Komisioner për Seksionin e Përgjithshëm:

1. Znj.Vilma Shurdha
2. Z.Andi Nano
3. Znj.Ermonela Ruspi
4. Znj. Aljona Mansaku

2 – Për pozicionin Komisioner në Seksionin për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor:

1. Z.Arjan Hoxha
2. Znj.Ermonela Ruspi
3. Z.Illir Kadiu
4. Z. Artan Ballabani

3 - Për pozicionin Komisioner në Seksionin për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe te tretëve që veprojnë për llogari të tyre;

1. Znj.Edlira Cimbi

2. **Z.Andi Nano**
3. **Znj.Vilma Shurdha**
4. **Znj.Erjona Canaj**

II- Jetëshkrimi i kandidatëve për komisionerë të përzgjedhur nga Avokati Popullit:

a - Kandidatë për Seksionin e Përgjithshëm

1- Znj.Vilma Shurdha *(është kandidatur që kandinson për dy seksione)*

Arsimimi: në vitin 1998, është diplomuar Jurist në Fakultetin e Drejtësisë Universiteti i Tiranës.

Përvoja Profesionale: Në vitet 1999 – 2001, Juriste Ministria e Kulturës; 2001 -2002 Studio Ligjore Boga, Juriste; 2002 -2006 Studio Ligjore Kalo, Juriste; 2007 – 2013 Agjencia Trajtimit të Konkencioneve – Drejtor i Vlerësimit të Konkencioneve; 2013 – 2018 “Optima Legal dhe Finance” – Juriste; maj 2018 – tetor 2018 “Ministria e Financës dhe Ekonomisë” – Këshilltare.

2- Z.Andi Nano *(është kandidatur që kandinson për dy seksione)*

Arsimimi: Në vitin 1994, është diplomuar Jurist në Fakultetin e Drejtësisë Univeristeti i Tiranës.

Përvoja Profesionale: Në vitet 1996 -2005, Këshilli i Ministrave / Departamenti i Zhvillimit Ekonomik – Jurist; Ministria e Ekonomisë - Sekretar i Përgjithshëm; Ministria e Integritetit – Këshilltar; 2005 – 2008 I.S.K.SH – Këshilltar - Drejtorja e Përgjithshme dhe Drejtorja Juridike; 2008 -2014 JTI Trading – Menaxher - Mardhënie.Ek.Kom; 2014- 2015 IPSED – Menaxher i Përgjithshëm; 2015 -2017 A.Portual Durrës – Drejtor Ekzekutiv; 2017 dhe vazhdim SMART.GIGS (OJF) – Drejtor Eekzekutiv.

3- Znj.Ermonela Ruspi – Arsimimi: Në vitin 2000, është diplomuar Jurist ne Fakultetin e Drejtësisë Universiteti A.Xhuvani Elbasan; 2004 -2007 Master Histori U.Tiranës – F.Filologji. Doktoratur Histori U.Tiranës 2011; Docent – U.E.Çabej Gjirokastrë; Profesor i Asocuar, U.E. Çabej Gjirokastrë 2015.

Përvoja Profesionale: Në vitet 2001 - 2003, Bashkia Fier – Juriste; 2003 dhe vazhdim U.E.Çabej Gjirokastrë - Pedagoge.

4- Znj.Aljona Mansaku - Arsimimi: Në vitin 1996, është diplomuar Jurist në Fakultetin e Drejtësisë Univeristeti i Tiranës; Master Profesional Administrim Publik U.T – F.E 2007 – 2016.

Përvoja Profesionale: Në vitet 1996 - 2000, KLSH – Inspektore - Juriste; 2000 - 2002 Prefektura Tiranë – Inspektor Kontrolli; 2003 - 2006 Komisioni i Letrave me Vlerë – Specialist/Shefe Div.Disiplinimit; 2006 -2009 AMF/ Drejtor i Çështjeve Juridike; 2009 -2013 KQZ – Sekretar i Përgjithshëm; prill 2013 – gusht 2013 M.Brendshme - Këshilltare; gusht 2013 – tetor 2013 Prefektura e Qarkut Tiranë – Prefekte; 2013 – 2015 Bashkia Tiranë/ Dr.M.Stehimit Social – Drejtor; 2016 dhe vazhdim Ministria e Drejtësisë Sek.Inspektimit të Organeve të Gjyqësorit - Inspektor, specialist.

b- Kandidatë për Seksionin për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Vendor:

1- Z. Arjan Hoxha - Arsimimi: në vitin 1994 – 1999, Akademia e Rendit Publik; në vitin 2007 është diplomuar Jurist në Fakultetin e Drejtësisë Universiteti i Tiranës; 2009 - 2011 Master Niveli/2 “E drejtë Kushtetuese e Krahësuar dhe Europiane”; Doktoratur – UET, “Të drejtat reale mbi sendet e huaja sipas legjislacionit shqiptar” 2011 -2018.

Përvoja Profesionale: Në vitet 1994 –2008, Policia e Shtetit; 2008 – 2013 D.P.Q.TR/DR/GJR – Shef Sek.Krim.Ek; 2013 -2016 Instituti Kosovar për Menaxhim - ekspert i jashtëm në fushën e legjislacionit; 2011 -2012 UAMD – FSHP/D Pedagog i Jashtëm; qershor 2017 – korrik 2017 Dr.Përgjithshme e Burgjeve – Drejtor i Përgjithshëm; 2014 dhe vazhdim Avokat.

2- Znj.Ermonela Ruspi *(është kandidatur që kandindon për dy seksione)*

Arsimimi: Në vitin 2000, është diplomuar Jurist në Fakultetin e Drejtësisë Universiteti A.Xhuvani Elbasan; 2004 -2007 Master Histori U.Tiranës – F.Filologji. Doktoratur Histori U.Tiranës 2011; Docent – U.E.Çabej Gjirokastrë; Profesor i Asocuar, U.E. Çabej Gjirokastrë 2015.

Përvoja Profesionale: Në vitet 2001 -2003 Bashkia Fier – Juriste; 2003 dhe vazhdim U.E.Çabej Gjirokastrë - Pedagoge.

3 – Z. Ilir Kadiu – Arsimimi: Në vitin 1999, është diplomuar Jurist në Fakultetin e Drejtësisë Univeristeti i Tiranës; në vitin 2011 Master Profesional UET “E drejtë Administrative”

Përvoja Profesionale: Në vitet 1999 -2001 Bashkia Durrës – Jurist; 2001 – 2006 ICM, RMCA,TDH (OJF) –Jurist, Koordinator Projekti; 2006 – 2007 A.Portual Durrës – Jurist; 2008 -2013 KLSH – Jurist; 2013 -2014 Kryeministri Drejtoria Antikorrupsion – Inspektor; Gjykata Tiranë – Kancelar.

4- Z.Artan Ballabani - Arsimimi: Në vitin 2000, është diplomuar Jurist në Fakultetin e Drejtësisë Univeristeti i Shkodrës L.Gurakuqi.

Përvoja Profesionale: Nga viti 2007 dhe vazhdim Prokuroria e Përgjithshme/ OPGJ në Prokurorinë Krujë, Mat.

c- Kandidatë për Seksionin për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe te tretëve që veprojnë për llogari të tyre;

1 – Znj.Edlira Cimbi - Arsimimi: Në vitin 1996, është diplomuar Jurist në Fakultetin e Drejtësisë Univeristeti i Tiranës.

Përvoja Profesionale: Në vitet 1995 – 1997, Tipografi At.Gjegj Fishta; 1997 -1998 Muzeu H.Kombëtar, Juriste; 1998 – 2002, Telekom Albania – Juriste/specialiste Departamenti Prokurimeve; 2002 - 2003 K.K.R.T – Juriste Departamenti Licencave; 2003 – 2009 Alb.Telekom SH.A – Juriste; 2009 – 2013 ARMO. SHA, Shefe Departamentit Juridik; 2013 – 2015, Partner Ballkanik SH.P.K – Juriste; 2015 – 2018 Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integuara – Drejtore e Administrimit të Brendshëm.

2- Z.Andi Nano *(është kandidatur që kandindon për dy seksione)*

Arsimimi: Në vitin 1994, është diplomuar Jurist në Fakultetin e Drejtësisë Univeristeti i Tiranës.

Përvoja Profesionale: Në vitet 1996 -2005, Këshilli i Ministrave / Departamenti i Zhvillimit Ekonomik – Jurist; Ministria e Ekonomisë - Sekretar i Përgjithshëm; Ministria e Integritetit – Këshilltar; 2005 – 2008 I.S.K.SH – Këshilltar - Drejtoria e Përgjithshme dhe Drejtoria Juridike; 2008 -2014 JTI Trading – Menaxher - Mardhënie.Ek.Kom; 2014- 2015 IPSED – Menaxher i Përgjithshëm; 2015 -2017 A.Portual Durrës – Drejtor Ekzekutiv; 2017 dhe vazhdim SMART.GIGS (OJF) – Drejtor Ekzekutiv.

3- Znj.Vilma Shurdha *(është kandidatur që kandindon për dy seksione)*

Arsimimi: në vitin 1998, është diplomuar Jurist në Fakultetin e Drejtësisë Universiteti i Tiranës.

Përvoja Profesionale: Në vitet 1999 – 2001, Juriste Ministria e Kulturës; 2001 -2002 Studio Ligjore Boga, Juriste; 2002 -2006 Studio Ligjore Kalo, Juriste; 2007 – 2013 Agjencia Trajtimit

4- Znj.Erjona Canaj - Arsimimi: Universiteti La Sapienza, Fakulteti i Drejtësisë, Romë It – Diplomë në Drejtësi 1999 – 2005; Master N/2 “E Drejtë Familjare” Universiteti “LUMSA”, Romë, Itali; Doktoraturë “ E Drejta e Bashkimit Familjar në BE”, Universiteti La Sapienza Romë, Itali; Prof.Asoc. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë viti 2015.

Përvoja Profesionale: Në vitet 2007 – 2008 Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë – Pedagoge; Nga viti 2008 dhe vazhdim “Universiteti European i Tiranës” – Pedagoge.

III – Procedura ligjore për zgjedhjen e Komisionereve të Avokatit të Popullit, neni 33/1 i ligji nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar:

Neni 33/1

Zgjedhja e komisionerëve

1. Komisioneri zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë për një mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
2. Avokati i Popullit, jo më vonë se tre muaj përpara përfundimit të mandatit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, publikon shpalljen për vendin vakant të komisionerit.
3. Në rastet e tjera të mbarimit të mandatit, sipas këtij ligji, shpallja për vendin vakant të komisionerit bëhet kryesisht nga Kuvendi, brënda 10 ditëve nga krijimi i vakancës.
4. Me ftesë të hapur publike të Avokatit të Popullit, çdo shtetas, i cili plotëson kushtet e parashikuara në këtë ligj, mund të paraqesë kandidaturën për komisioner pranë Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit merr në shqyrtim dhe verifikon përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të çdo kandidature, me anë të një procesi të hapur dhe publik.
5. Avokati i Popullit, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, organizon procesin për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave.
6. Lista me katër kandidatët e përzgjedhur nga Avokati i Popullit për çdo vend vakant, së bashku me vlerësimin e tij për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore dhe renditjen e kandidaturave, sipas preferencës së tij, i kalon komisionit të Kuvendit që mbulon çështjet ligjore, jo më vonë se 45 ditë përpara përfundimit të mandatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.
7. Komisioni i Kuvendit që mbulon çështjet ligjore organizon seanca dëgjimore publike me katër kandidatët e përzgjedhur për çdo vend vakant nga Avokati i Popullit.
8. Pas marrjes në shqyrtim të katër kandidaturave për çdo vend vakant, komisioni përzgjedh për t’iu paraqitur për votim Kuvendit dy kandidatë, ose në rast barazie votash edhe më shumë kandidatë, të cilët gëzojnë mbështetjen më të madhe midis anëtarëve të komisionit.
9. Kandidatët e përzgjedhur, sipas procedurës së parashikuar në pikat 7 dhe 8 të këtij neni, i kalojnë Kuvendit për votim.

IV/a- Në seancën dëgjimore të datës 17.12.2018, u paraqitën kandidatët për komisioner të ndarë sipas (3) tre seksioneve, si më poshtë vijon:

1 – Për pozicionin Komisioner për Seksionin e Përgjithshëm:

1. Znj.Vilma Shurdha
2. Z.Andi Nano
3. Znj.Ermonela Ruspi

2 – Për pozicionin Komisioner në Seksionin për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor:

1. Z.Arjan Hoxha

2. Znj.Ermonela Ruspi
3. Z.Illir Kadiu
4. Z. Artan Ballabani

3 - Për pozicionin Komisioner në Seksionin për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre;

1. Znj.Edlira Cimbi
2. Z.Andi Nano
3. Znj.Vilma Shurdha
4. Znj.Erjona Canaj

Në seancën dëgjimore të datës 17.12.2018, nuk u paraqit kandidatja për komisioner në Seksionin e Përgjithshëm Znj.Aljona Mansaku.

V- Pas përfundimit të seancave dëgjimore me kandidatët, “Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”, në zbatim të nenit 33/1 pika 8, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, në mbledhjen e datës 11.02.2019, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm përzgjedhi për t’iu paraqitur për votim Kuvendit, kandidatët për komisioner për tre vendet vakante, si më poshtë vijon:

1- Për një (1) vend vakant për Komisionerë në “**Seksionin e Përgjithshëm**”, Komisioni vendosi t’i propozoj Kuvendit për votim kandidaturat e mëposhtme:

1. Znj.Vilma Shurdha
2. Z.Andi Nano

2- Për një (1) vend vakant për Komisionerë në “**Seksionin për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor**”, Komisioni vendosi t’i propozoj Kuvendit për votim kandidaturat e mëposhtme:

1. Znj.Ermonela Ruspi
2. Z.Illir Kadiu

3-Për një (1) vend vakant për Komisionerë në “**Seksionin e Organeve të Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të Tretëve për Llogari të tyre**”, Komisioni vendosi t’i propozoj Kuvendit për votim kandidaturat e mëposhtme:

1. Znj.Edlira Cimbi
2. Znj.Erjona Canaj

**KRYETARI
Ulsi MANJA**

**RELATORE
Klotilda BUSHKA**

